



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE

Maj 2024

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

Maj 2024

© Ministria e Financave, 2024

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

**E-mail:** [Dajana.Metolli@financa.gov.al](mailto:Dajana.Metolli@financa.gov.al)

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** \_\_\_\_\_ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** \_\_\_\_\_ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit \_\_\_\_\_ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit \_\_\_\_\_ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave \_\_\_\_\_ 5
4. Bilanci i Pagesave \_\_\_\_\_ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar \_\_\_\_\_ 7
6. Kredia për Ekonominë \_\_\_\_\_ 8
7. Oferta e Parasë \_\_\_\_\_ 9
8. Depozitat sipas burimeve \_\_\_\_\_ 10

**SEKTORI FISKAL** \_\_\_\_\_ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar \_\_\_\_\_ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve \_\_\_\_\_ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal \_\_\_\_\_ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** \_\_\_\_\_ **13**


# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin maj 2024, arriti në 116.8;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin maj 2024 ishte 2.2 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin maj 2024 ishte 93.00 lekë për dollarë dhe 100.50 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit maj 2024 shënuan kuotën 2.09 dhe 2.79 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit maj 2024 shënuan përkatësisht vlerat 6.73 dhe 6.90 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,690,401 milionë lekë në muajin maj 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 3.3 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të 2024 rezultoi me rënien e mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 280.05 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën maj 2024 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 50.470 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një sufiçit prej 25.531 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për maj 2024, arritën në rreth 287.085 miliardë lekë ose afërsisht 11.2 përqind më shumë se muaji maj 2023 dhe 103.4 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 236.615 miliardë lekë ose rreth 6.5 përqind më shumë se muaji maj 2023 dhe 93.8 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin maj 2024 shënoi 2.2%, duke reflektuar një rënie në krahasim me një vit më parë ku ky ndryshim shënoi 4.7%. Ndryshimi mujor i Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), në muajin maj 2024 krahasuar me prill 2024 ka shënuar rënie me -0.2%. Referuar një viti më parë IÇK për muajin maj 2023 shënoi rënie mujore prej 0.3 % në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +1.9%, duke kontribuar me +0.69 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.42 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +3.7%, duke kontribuar me

+0.28 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.

- “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +2.5%, duke kontribuar me +0.14 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +0.15 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +2.4%, duke kontribuar me +0.11 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2023	7.2	7.1	5.3	4.6	4.7	4.5	4.2	4.0	4.1	3.8	3.9	4.0
2024	3.4	2.6	2.3	2.1	2.2							

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin maj 2024, arriti në 100.50 lekë/euro, duke u ulur me 0.94 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit maj një euro u këmbye me 100.86 lekë.


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin maj 2024 arriti në 93.00 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 1.76 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit maj, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 93.01 lekë/dollarë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.93 dollarë/euro për muajin maj 2024.

Në krahasim me muajin maj të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezultojnë se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane


në masën 9.52 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezultojnë se është mbiçmuar në masën 9.08 përqind. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjesshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimi i lekut mund të shpjegohet me përmirësimet në bilancin e llogarisë korrente, rritjen e investimeve të huaja direkte, me efektet e normalizimit të politikës monetare si dhe si rezultat i stabilitetit të situatës makroekonomike në vend.




### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit maj 2024, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatat jo-financiare shënuan përkatësisht normat prej 2.09 dhe 2.79 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas individëve kanë shënuar rritje me 0.05 pikë përqindje dhe Korporatat jo-financiare kanë shënuar rënie me 0.58 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 0.53 pikë përqindje për Individët dhe një rënie me 0.20 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin maj 2024 kanë shënuar kuotën 3.54 përqind, nga 3.65 përqind që shënonte për të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore shënoi rënie me 0.15 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe rënie vjetore me 0.11 pikë përqindje.

Gjatë muajit maj 2024 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht normat 6.73 dhe 6.90 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas individëve u ulën me 0.15 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas korporatave jo-financiare u rritën me 0.36 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rënie me 0.23 pikë përqindje për Individët dhe janë rritur me 0.17 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.





## 4. Bilanci i Pagesave

Përgjatë tremujorit të parë të 2024, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ, në rënie të mjeteve të rezervës valutore, prej rreth 280.05 milionë euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2023 që shënoi vlerën 83.3 milionë euro. Për tremujorin e parë të 2024, “Llogaria korrente” e zgjeroi deficitin në -371.4 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 243.3 milionë euro, si pasojë e përkeqësimit të bilancit tregtar të mallrave. Në kahun pozitiv, kontribut në zbutje të deficitit korrent dha zgjerimi i balancave pozitive në tregtinë e shërbimeve dhe në të ardhurat dytësore së bashku me ngushtimin e balancës negative të të ardhurave parësore.

Në tremujorin e parë të 2024, zëri i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me “Turizmin” regjistroi vlerën 788 milionë euro, ose rreth +26.3% krahasuar me 624 milionë euro në tremujorin e parë të 2023. Për tremujorin e parë të 2024, “Remitancat” janë në vlerën 242 milionë euro, ose +13.2%, krahasuar me 214 milionë euro në tremujorin e parë të 2023.


Në tremujorin e parë të 2024, “Llogaria financiare dhe kapitale” u ngushtua në 81 milionë euro, krahasuar me 144 milionë euro në tremujorin e parë të 2023. Për tremujorin e parë të 2024, IHD regjistruan vlerën 354 milionë euro ose +15.2%, krahasuar me 307.3 milionë euro në tremujorin e parë të 2023.






## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit maj 2024, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 57,332 milionë lekë krahasuar me muajin maj 2023. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankat Para-depozituese me 44,062 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 604 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 5,440 milionë lekë në Bankën Qëndrore.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,690,401 milionë lekë në muajin maj 2024 duke shënuar një rritje prej rreth 53,240 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.3 përqind.

Në muajin maj, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 13,059 milionë lekë.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin maj 2024 arriti në rreth 782,965 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 70,322 milionë lekë, ose rritje me rreth 9.87 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (58.4%) dhe monedhave të huaja (41.6%).


Gjatë muajit maj 2024, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredisë, me rreth 56.0 përqind ose 438,222 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.6 përqind ose rreth 302,314 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.5 dhe 2.9 përqind apo 19,515 dhe 22,850 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin maj 2024 zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredisë, me rreth 70.1 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.6 përqind. “Korporata të tjera financiar” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.5 dhe 2.8 përqind secili.




## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 389,430 milionë lekë në fund të muajit maj 2024. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në maj 2024 ka shënuar një rritje mujore prej 0.08 përqind dhe rënie vjetore prej 0.43 përqind, duke arritur nivelin 23.0 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.13 përqind, dhe rënie vjetore prej 0.72 përqind, duke shënuar nivelin 29.9 përqind.





Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin maj 2024, kanë shënuar rritje vjetore prej 804 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 73.6 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit maj 2024 shënuan rritje prej 47,136 milionë lekë në krahasim me muajin maj 2023. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 75.7 përqind të depozitave në lekë



## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit maj 2024, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.7 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 18.4 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.7 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.6 përqind dhe rreth 23.7 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 74.5 përqind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 969,666 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (276,659 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (29,980 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (4,654 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit maj 2024, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,300,972 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 11,325 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 47,940 milionë lekë.




# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën progresive maj 2024 janë mbledhur rreth 287.085 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 236.615 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 216.116 miliardë lekë shpenzimet korrente dhe rreth 92.206 miliardë lekë shpenzimet për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 183.612 miliardë lekë (1.6% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 18.076 miliardë lekë (53.2% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 65.695 miliardë lekë (ose rreth 2.5% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 18.347 miliardë lekë (ose rreth 0.6% më shumë se plani i periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 216.116 miliardë lekë, 43.124 miliardë lekë (19.95% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 22.150 miliardë lekë (10.24% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 22.070 miliardë lekë (10.21% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 449 milionë lekë (0.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 92.206 miliardë lekë (42.66%) për shpenzime për fonde speciale, 25.098 miliardë lekë (11.61% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 11.019 miliardë lekë (5.09% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën maj 2024 ishin rreth 287.09 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 267.38 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 18.35 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat tatimore gjatë muajit Maj 2024 (mln Lekë)

Emërtimi	Maj'24	Maj'23	Maj'24/Maj'23 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	84,949	76,829	10.6
Tatimi mbi Fitimin	27,574	29,262	-5.8
Akcizat	23,125	21,134	9.4
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	26,778	22,786	17.5
Taksa Nacionale dhe të tjera	17,662	15,658	12.8
Taksa Doganore	3,524	3,487	1.1

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Korrik 2024

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për periudhën janar-maj 2024 shënoi një vlerë pozitive prej 50.470 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një sufiçit prej 25.531 miliardë lekë, ndikuar nga rritja më e shpejtë e të ardhurave në raport me planifikimin.

Për periudhën maj 2024, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 287.085 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 236.615 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave progresive për periudhën maj 2024, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 267.382 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 216.116 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 92.206 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly)					Vjetor (Annual)					Month
	2020	2021	2022	2023	2024	2020	2021	2022	2023	2024	2020	2021	2022	2023	2024	
Janar	1.9	1.3	1.3	1.1	0.5	1.9	1.3	1.3	1.1	0.5	1.5	0.4	3.7	7.2	3.4	January
Shkurt	0.4	1.1	1.3	1.1	0.3	1.1	1.2	1.3	1.1	0.4	1.2	1.1	3.9	7.1	2.6	February
Mars	0.6	0.7	2.4	0.7	0.4	0.9	1.0	1.7	1.0	0.4	2.1	1.2	5.7	5.3	2.3	March
Prill	-0.4	0.2	0.7	0.03	-0.2	0.6	0.8	1.4	0.9	0.3	1.9	1.9	6.2	4.6	2.1	April
Maj	-0.8	-0.9	-0.5	-0.3	-0.2	0.3	0.5	1.0	0.7	0.2	2.1	1.8	6.7	4.7	2.2	May
Qershor	-0.6	-0.8	-0.1	-0.3		0.2	0.3	0.9	0.6		1.8	1.6	7.4	4.5		June
Korrik	-0.5	0.1	0.2	-0.1		0.1	0.2	0.8	0.5		1.4	2.2	7.5	4.2		July
Gusht	0.2	0.4	0.8	0.6		0.1	0.3	0.8	0.5		1.3	2.4	8.0	4.0		August
Shtator	0.4	0.5	0.6	0.7		0.1	0.3	0.7	0.4		1.5	2.5	8.1	4.1		September
Tetor	0.2	0.1	0.4	0.1		0.1	0.3	0.7	0.4		2.0	2.4	8.3	3.8		October
Nëntor	-0.5	0.2	-0.3	-0.2		0.1	0.3	0.6	0.3		1.6	3.1	7.9	3.9		November
Dhjetor	0.3	0.8	0.4	0.5		0.1	0.3	0.6	0.3		1.1	3.7	7.4	4.0		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

**Tab - 2** Kursi i këmbimit  
Exchange rate

Monedha					2024	2024	2024	2024	2024	Currency
	2020	2021	2022	2023	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Mesatarja e periudhës:</b>										<b>Average of period</b>
USD	108.65	103.68	113.04	100.65	95.33	96.29	95.32	94.64	92.98	USD
EURO	123.77	122.37	118.98	108.80	103.91	103.91	103.57	101.48	100.52	EURO
<b>Fundi i periudhës</b>										<b>In the end of period</b>
USD	100.84	106.54	107.05	93.94	95.95	95.92	95.37	93.77	93.01	USD
EURO	123.70	120.76	114.23	103.88	103.90	103.99	102.87	100.64	100.86	EURO

**Burimi** : Banka e Shqipërisë

**Source** : Bank of Albania



Tab - 3

**Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)***Annual Interest Rates (in ALL)*

Në përqindje	2024 Janar January	2024 Shkurt February	2024 Mars March	2024 Prill April	2024 Maj May	In percent
<b>Norma e interesit të depozitave për individë</b>						<b>Interest rates on households deposits</b>
Deri në 1 vit	1.07	1.72	1.70	1.56	1.76	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.77	2.83	2.84	2.67	2.75	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.93	3.10	3.22	3.25	3.04	Over 2 years
<b>Norma e interesit të depozitave për korporatat jo-financiare</b>						<b>Interest rates on nonfinancial corporations deposits</b>
Deri në 1 vit	3.01	2.27	1.85	3.35	2.76	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.49	2.88	3.17	3.38	3.18	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	4.69	4.50	4.54	3.77	3.59	Over 2 years
<b>Normat e interesit të kredive per individet</b>						<b>Interest rates on household loans</b>
Kredi për banesa	4.35	4.75	4.29	4.27	3.95	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	9.89	9.75	9.34	9.55	9.46	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	10.46	11.08	12.36	12.75	13.12	Credit for other purposes
<b>Normat e interesit të kredive per korporatat jofinanciare</b>						<b>Interest rates on nonfinancial corporations loans</b>
Kredi deri në 140 milion lekë	6.86	6.77	7.06	7.28	7.27	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	7.35	7.01	5.85	5.75	6.60	Loans over an amount of 140 millions of lek
<b>Norma e letrave me vlerë</b>						<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/						Treasury bills 1/
3-M	3.09	-	-	3.05	-	3-M
6-M	-	3.28	-	-	-	6-M
12-M	3.48	3.62	3.63	3.69	3.54	12-M

**Burimi** : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2024

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2024

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	January Janar	February Shkurt	March Mars	April Prill	May Maj	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>54,516</b>	<b>104,291</b>	<b>164,283</b>	<b>231,994</b>	<b>287,085</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>170</b>	<b>354</b>	<b>848</b>	<b>1,313</b>	<b>1,355</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>52,589</b>	<b>100,122</b>	<b>158,030</b>	<b>214,706</b>	<b>267,382</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>36,346</b>	<b>69,613</b>	<b>111,763</b>	<b>147,285</b>	<b>183,612</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	18,310	35,469	51,794	67,054	84,949	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,859	5,959	18,651	24,500	27,574	Profit Tax
3	Akcizat	4,299	8,553	13,054	17,714	23,125	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	5,710	10,484	15,288	21,046	26,778	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,528	7,858	10,988	14,185	17,662	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	639	1,290	1,987	2,787	3,524	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,447</b>	<b>3,597</b>	<b>7,064</b>	<b>14,289</b>	<b>18,076</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	257	551	1,253	3,168	3,831	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	7	12	18	27	38	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,182	3,034	5,793	11,094	14,207	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>14,797</b>	<b>26,912</b>	<b>39,204</b>	<b>53,132</b>	<b>65,695</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	12,748	23,287	33,981	45,960	56,836	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	2,013	3,576	5,150	7,067	8,702	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	35	50	73	105	157	Compensation income in the value of owners
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,758</b>	<b>3,814</b>	<b>5,404</b>	<b>15,975</b>	<b>18,347</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,023	2,347	3,217	4,783	5,783	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	246	477	660	947	1,270	Utility fees
4	Të tjera	489	990	1,528	2,327	3,376	Others
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>39,090</b>	<b>83,719</b>	<b>131,946</b>	<b>186,413</b>	<b>236,615</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>38,576</b>	<b>82,488</b>	<b>125,650</b>	<b>170,676</b>	<b>216,116</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personell</b>	<b>8,461</b>	<b>17,145</b>	<b>25,749</b>	<b>34,418</b>	<b>43,124</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	7,264	14,718	22,082	29,500	36,961	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,183	2,375	3,558	4,754	5,963	Social insurance contributions
3	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	13	53	108	164	200	Higher education from its own income
I.2	<b>Interesat</b>	<b>6,870</b>	<b>11,884</b>	<b>16,619</b>	<b>19,666</b>	<b>22,150</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	5,767	10,105	13,395	15,609	16,775	Domestic
2	Të Huaja	1,103	1,778	3,224	4,057	5,376	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,784</b>	<b>6,067</b>	<b>9,832</b>	<b>15,719</b>	<b>22,070</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveclonet</b>	<b>39</b>	<b>93</b>	<b>210</b>	<b>310</b>	<b>449</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>16,709</b>	<b>35,365</b>	<b>53,490</b>	<b>73,214</b>	<b>92,206</b>	<b>Social Insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	13,306	26,617	40,673	54,863	69,306	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	3,403	8,514	12,475	18,007	22,556	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	0	234	342	344	344	Owners' Compensation Fund
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>3,040</b>	<b>7,953</b>	<b>13,416</b>	<b>18,709</b>	<b>25,098</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,674</b>	<b>3,981</b>	<b>6,335</b>	<b>8,640</b>	<b>11,019</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	61	134	204	277	348	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,513	3,507	5,504	7,517	9,544	Economic Aid
3	Bonusi I lindjeve	100	300	500	600	800	Birth bonus
I.8	<b>Transferime Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>20</b>	<b>39</b>	<b>Capital transfers</b>
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>514</b>	<b>1,080</b>	<b>6,297</b>	<b>15,717</b>	<b>20,460</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	0	95	2,647	10,526	13,679	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	0	18	59	161	211	From higer education system's own revenues
3	Financimi Huaj	513	968	3,282	3,982	4,741	Foreign financed
IV	<b>Fondi i rindertimit</b>	<b>0</b>	<b>151</b>	<b>308</b>	<b>1,048</b>	<b>1,828</b>	<b>Reconstruction fund</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>15,426</b>	<b>20,571</b>	<b>32,336</b>	<b>45,582</b>	<b>50,470</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-15,438</b>	<b>-20,571</b>	<b>-32,336</b>	<b>-45,582</b>	<b>-50,470</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-12,195</b>	<b>-14,749</b>	<b>-30,537</b>	<b>-30,537</b>	<b>-41,475</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	1	2	2	2	3	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-12,000	-12,745	-790	-399	13,024	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-196	-2,006	-29,749	-37,716	-54,502	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>-3,243</b>	<b>-5,823</b>	<b>-1,799</b>	<b>-7,469</b>	<b>-8,995</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	348	1,211	3,292	3,776	4,010	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	8	-551	-979	-1,200	-713	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-3,599	-6,482	-9,344	-15,278	-17,523	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	5,232	5,232	5,232	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2024**

*Table of investments 2024*

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	
	January	February	March	April	May	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>-12,195</b>	<b>-14,749</b>	<b>-30,537</b>	<b>-38,112</b>	<b>-41,475</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	79.0	71.7	94.4	83.6	82.2	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>-3,243</b>	<b>-5,823</b>	<b>-1,799</b>	<b>-7,469</b>	<b>-8,995</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	21.0	28.3	5.6	16.4	17.8	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-15,438</b>	<b>-20,571</b>	<b>-32,336</b>	<b>-45,582</b>	<b>-50,470</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

**Burimi:** Ministria e Financave

**Source:** Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2024  
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2024**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
Taksë doganore	639	1,290	1,987	2,787	3,524	Customs Duties
TVSH	9,908	21,713	34,282	47,416	61,780	V.A.T
Akcizë	4,299	8,554	13,054	17,714	23,125	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	187	401	722	996	1,257	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>15,034</b>	<b>31,957</b>	<b>50,045</b>	<b>68,913</b>	<b>89,686</b>	<b>Total</b>
<b>TË ARDHURAT TATIMORE 2023 (TAX REVENUE)</b>						
TVSH	8,402	13,757	17,512	19,638	23,168	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,859	5,959	18,651	24,500	27,574	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	5,710	10,484	15,288	21,045	26,778	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	4,341	7,457	10,266	13,189	16,405	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>21,312</b>	<b>37,657</b>	<b>61,718</b>	<b>78,373</b>	<b>93,925</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>36,346</b>	<b>69,614</b>	<b>111,763</b>	<b>147,285</b>	<b>183,611</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

**Burimi:** Ministria e Financave

**Source:** Ministry of Finance

Tab - 7

**DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2024***The Deficit and Its Financing for 2024**Të dhëna progresive (Progressive Data)**Në milionë lekë (In million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>TË ARDHURAT</b>	54,516	104,291	164,283	231,994	287,085	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	39,078	83,719	131,946	186,413	236,615	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	15,438	20,571	32,336	45,582	50,470	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	-15,438	-20,571	-32,336	-45,582	-50,470	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	-12,195	-14,749	-30,537	-38,112	-41,475	<b>Domestic</b>
Të ardhura nga privatizimi	1	2	2	2	3	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	-12,000	-12,745	-790	-399	13,024	Domestic borrowing
Të tjera	-196	-2,002	-29,749	-37,716	-54,502	Others
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>-3,243</b>	<b>-5,823</b>	<b>-1,799</b>	<b>-7,469</b>	<b>-8,995</b>	<b>Foreign</b>
a. Hua afatgjatë(e marrë)	348	1,211	3,292	3,776	4,010	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjendjes së arkes*	8	-551	-979	-1,200	-713	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-3,599	-6,482	-9,344	-15,278	-17,523	Repayments
d. Mbështetje Buxhetore	0	0	5,232	5,232	5,232	Budgetary Support

**Burimi:** Ministria e Financave**Source:** Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	2020	2021	2022	2023	T1-2023	T2-2023	T3-2023	T4-2023	T1-2024	
<b>Llogaria korrente</b>	<b>-1,152.60</b>	<b>-1,166.43</b>	<b>-1,063.27</b>	<b>-190.51</b>	<b>-128.07</b>	<b>-197.55</b>	<b>367.23</b>	<b>-232.11</b>	<b>-371.40</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-2,982.51</b>	<b>-3,829.34</b>	<b>-4,268.90</b>	<b>-4,539.87</b>	<b>-890.93</b>	<b>-1,220.06</b>	<b>-1,207.39</b>	<b>-1,221.49</b>	<b>-1,236.16</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti i mallrave fob	793.63	1,264.79	1,932.55	1,836.09	486.85	425.48	420.09	503.67	389.57	Merchandise Exports. Fob
Importi i mallrave fob	-3,776.14	-5,094.13	6,201.59	6,375.96	1,377.78	1,645.53	1,627.48	1,725.17	1,625.73	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>1,051.72</b>	<b>1,776.10</b>	<b>2,401.33</b>	<b>3,430.90</b>	<b>564.22</b>	<b>791.88</b>	<b>1,322.32</b>	<b>752.47</b>	<b>629.13</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	2,226.22	3,466.03	4,801.38	6,644.61	1,198.08	1,521.36	2,359.44	1,565.73	1,365.11	Services Credit
Shërbimet Debi	1,174.50	1,689.93	2400.05	3213.71	633.86	729.48	1037.12	813.26	735.98	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-219.34</b>	<b>-210.93</b>	<b>-314.76</b>	<b>-278.31</b>	<b>-72.10</b>	<b>-69.12</b>	<b>-51.54</b>	<b>-85.56</b>	<b>-60.86</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	337.10	397.57	596.79	771.30	155.36	186.01	214.78	215.15	204.02	Income Credit
Të ardhurat Debi	-556.44	608.55	911.54	1,049.61	227.46	255.13	266.32	300.71	264.88	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>997.40</b>	<b>1,077.96</b>	<b>1,119.05</b>	<b>1,196.78</b>	<b>1,196.78</b>	<b>299.75</b>	<b>303.83</b>	<b>322.47</b>	<b>296.48</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	1,169.70	1,244.00	1,280.21	1,367.95	309.69	342.17	347.68	368.42	344.25	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-172.30	-166.04	161.16	171.18	38.95	42.43	43.85	45.95	47.77	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>143.60</b>	<b>358.46</b>	<b>20.14</b>	<b>45.81</b>	<b>16.49</b>	<b>119.33</b>	<b>-40.23</b>	<b>-49.78</b>	<b>-75.51</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>-1,504.34</b>	<b>-1,564.51</b>	<b>-819.20</b>	<b>-1,017.64</b>	<b>-127.48</b>	<b>-586.07</b>	<b>64.87</b>	<b>-368.96</b>	<b>-156.47</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	-893.56	-989.93	-1,189.95	-1,247.47	-255.80	-301.39	-344.51	-345.77	-301.76	Direct Investment
Investime portofoli	-65.85	-96.46	573.11	325.01	14.99	-306.96	312.68	304.30	159.26	Portfolio Investment
Investime të tjera	-403.83	-531.66	-264.84	-198.70	93.47	11.53	56.11	-359.82	-54.99	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>159.32</b>	<b>178.83</b>	<b>154.14</b>	<b>63.87</b>	<b>67.38</b>	<b>34.80</b>	<b>-101.97</b>	<b>63.66</b>	<b>10.35</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>654.66</b>	<b>936.17</b>	<b>-69.79</b>	<b>936.81</b>	<b>83.28</b>	<b>542.65</b>	<b>160.15</b>	<b>150.73</b>	<b>-280.09</b>	<b>Overall Balance</b>
Rezervat	654.65	936.17	-69.79	936.81	83.28	542.62	160.15	150.73	-280.09	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	141.10	-53.54	-62.48	-103.53	-19.86	-10.75	-40.58	-32.33	-41.03	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**MJETET VALUTORE NETO**

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë	2020	2021	2022	2023	2024	2024	2024	2024	2024	2023
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	
Fundi i periudhes					January	February	March	April	May	Millions of Lek
										End of Period
<b>Mjete valutore neto</b>	803,487	937,814	892,687	934,539	979,164	973,632	970,977.28	937,254.71	937,859.28	<b>Net foreign assets</b>
Pretendime ndaj jorezidentëve	860,750	1,027,069	981,133	1,015,832	1,067,623	1,060,949	1,059,657.49	1,026,289.99	1,026,051.41	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	57,263	89,255	88,446	81,293	88,459	87,317	88,680.21	89,035.28	88,192.13	Minus: Liabilities to nonresidents
<b>Mjetet e brendshme</b>	1,047,835	1,084,106	1,211,348	1,186,624	1,240,128	1,243,320	1,235,383.79	1,243,530.37	1,254,867.48	<b>Domestic assets</b>
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	435,613	412,253	491,750	462,149	492,892	487,182	465,621.27	466,399.05	465,739.92	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektoreve te tjere	612,221	671,852	719,598	724,475	747,237	756,139	769,762.52	777,131.32	789,127.56	Claims on other sectors
<b>Detyrimet e parasë së gjerë</b>	1,456,993	1,582,310	1,659,293	1,660,053	1,708,882	1,703,052	1,690,659.61	1,677,342.05	1,690,401.09	<b>Broad Money liabilities</b>
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	344,560	366,251	387,652	389,052	388,326	387,896	389,965.07	387,695.48	389,429.64	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	490,394	584,631	645,637	654,894	702,764	696,985	684,231.27	675,609.87	686,180.52	Transferable deposits
Depozita të tjera	622,039	631,428	626,005	616,107	617,792	618,171	616,463.26	614,036.70	614,790.93	Other deposits
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjërë</b>	186,892	222,409	248,219	254,320	304,844	307,201	310,481.97	310,755.38	310,294.13	<b>Deposits excluded from Broad Money</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike										Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	4,666	5,877	7,250	7,370	8,579	8,761	9,009.71	8,450.64	9,181.63	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	252	392	382	374	338	330	331.14	372.87	335.59	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,925	16,599	10,186	12,357	16,072	14,437	15,810.85	17,076.72	16,040.65	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	175,050	199,541	230,401	251,971	279,855	283,672	285,330.26	284,855.14	284,736.26	Other resident sectors
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	5,926	7,288	7,925	8,873	13,307	13,058	14,740.16	14,593.84	14,657.10	<b>Securities other than shares</b>
Korporata të tjera jofinanciare	57	67	291	668	608	596	922.18	920.00	924.68	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	5,869	7,221	7,634	8,205	12,699	12,462	13,817.98	13,673.84	13,732.42	Other resident sectors
<b>Huatë</b>	3,757	3,507	4,636	5,802	9,642	11,804	7,781.11	6,130.63	8,790.24	<b>Loans</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike										Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	3,757	3,507	4,636	5,802	9,642	11,804	7,781.11	6,130.63	8,790.24	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike										Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare										Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë										other resident sectors
<b>Llogari të pagueshme</b>	62	248	86	125	363	912	411.70	749.61	424.29	<b>Accounts payable</b>
Korporata të tjera Financiare										Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike										Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	5		69	20	1	527	1.76	302.33	1.17	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	57	247	17	105	362	385	409.95	447.27	423.11	other resident sectors
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit</b>	214,394	219,725	185,627	185,828	197,891	198,373	190,847.30	184,418.64	186,786.48	<b>Shares and other equity</b>
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-1,095	-5,442	-46,110	-63,348	-70,979	-73,778	-74,550.63	-83,996.79	-83,448.73	Of which: Valuation adjustment
<b>Të tjera neto</b>	-17,621	-14,428	-12,607	-13,287	-16,665	-19,526	-10,023.53	-14,972.55	-21,395.17	<b>Other items net</b>
Detyrime të tjera	55,892	59,094	63,859	63,136	65,486	61,160	67,829.97	64,018.79	57,479.17	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	73,514	73,521	76,467	76,423	82,151	80,686	77,853.49	78,991.34	78,874.33	Minus: Other assets
<b>Axhustimi i konsolidimit</b>	919.0	862	4,826	1,191	1,030	2,078	1,462.69	1,767.58	2,768.70	<b>Consolidation adjustment</b>

Burlmi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab -  
10 **KREDIA PËR EKONOMINË**  
*Credit to Economy*

Në million Lekë Fundi i periudhës	2020	2021	2022	2023	2024	2024	2024	2024	2024	Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Totali i kredisë</b>	608,779.8	666,178.4	713,289	744,162.7	740,996.2	749,947.3	763,588.60	770,970.50	782,965.30	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike</b> □	429.1	313.2	205	103.0	93.8	88.0	78.8	69.6	63.8	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	429.1	313.2	205	103.0	93.8	88.0	78.8	69.6	63.8	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	15,150.8	22,521.8	23,714	16,754.0	18,445.2	17,903.8	18,462.1	19,199.7	19,514.9	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në lekë	11,819.6	9,210.6	10,509	9,247.1	8,833.1	8,392.3	8,939.2	9,951.10	10,231.30	in Lek
Në valutë	3,331.2	13,311.3	13,205	7,506.9	9,612.1	9,511.5	9,522.9	9,248.6	9,283.6	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera jofinanciare</b>	370,356.3	395,162.7	411,853	421,985.1	414,845.7	420,183.9	427,857.5	432,093.0	438,222.3	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në lekë	161,975.3	172,000.2	173,607	196,936.3	194,631.7	200,152.8	205,909.7	209,341.4	209,818.2	in Lek
Në valutë	208,381.0	223,162.5	238,246	225,048.8	220,214.0	220,031.1	221,947.8	222,751.6	228,404.1	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	13,169.1	13,815.7	15,557	19,468.3	19,904.5	21,023.2	21,368.7	21,780.7	22,849.9	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në lekë	7,489.2	7,772.8	8,669	12,411.3	12,330.7	13,173.3	13,468.9	14,058.9	14,790.0	in Lek
Në valutë	5,679.9	6,043.0	6,888	7,057.0	7,573.8	7,849.9	7,899.8	7,721.8	8,059.9	in Foreign Currency
<b>Kredia për sektorë të tjerë rezidentë</b>	209,674.5	234,365.0	262,223	285,852.0	287,707.1	290,748.3	295,821.5	297,827.4	302,314.3	<b>Credits to other resident sectors</b>
Në lekë	138,986.4	158,093.0	175,901	204,247.5	206,700.0	209,612.5	214,231.6	217,921.6	222,061.8	in Lek
Në valutë	70,688.1	76,272.0	86,322	81,604.7	81,007.1	81,135.8	81,589.9	79,905.8	80,252.5	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



Tab - 11

**OFERTA E PARASË**

Money Supply

Mujor-Monthly

Në million Lekë	2020	2021	2022	2023	2024 Janar	2024 Shkurt	2024 Mars	2024 Prill	2024 Maj	Millions of LEK End of Period
Fundi I perludhës					January	February	March	April	May	
Baza monetare	480,352	573,510	539,812	584,588	567,139	556,912	554,178	525,082	531,127	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	344,560	366,251	387,652	393,555	388,326	387,896	389,965	387,696	389,430	Currency outside depository corporations
Agregati M1	637,317	701,404	735,839	772,513	779,977	778,481	774,591	764,200	773,857	M1 Aggregate
Agregati M2	862,338	918,474	939,309	972,613	981,446	979,527	977,843	968,552	978,531	M2 Aggregate

**Burimi** : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

## DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundit I perludhës	2020	2021	2022	2023	2024 Janar January	2024 Shkurt February	2024 Mars March	2024 Prill April	2024 Maj May	Millions of Leks End of Period
	<b>Totali i depozitave</b>	<b>1,112,433</b>	<b>1,216,059</b>	<b>1,271,642</b>	<b>1,271,001</b>	<b>1,320,556</b>	<b>1,315,156</b>	<b>1,300,694.54</b>	<b>1,289,646.57</b>	
<b>Në lekë</b>	<b>517,778</b>	<b>552,223</b>	<b>551,657</b>	<b>550,867</b>	<b>593,120</b>	<b>591,631</b>	<b>587,878.11</b>	<b>580,855.97</b>	<b>589,101.45</b>	
<b>Depozitat e transferueshme</b>	<b>241,316</b>	<b>276,074</b>	<b>291,263</b>	<b>296,115</b>	<b>337,465</b>	<b>335,562</b>	<b>329,223.20</b>	<b>320,903.98</b>	<b>328,138.83</b>	<b>Transferable deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,644	1,302	1,694	1,868	1,985	1,946	1,916.39	4,310.25	4,277.51	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	13,747	17,118	16,031	17,002	21,460	20,716	17,670.72	14,555.17	16,125.27	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,666	4,744	7,045	5,037	4,552	7,185.28	7,195.53	3,891.50	4,476.53	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	66,074	77,758	77,667	82,550	108,382	102,043	97,070.56	93,557.20	95,006.81	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	156,185	175,154	188,826	189,658	201,087	203,672	205,370.01	204,589.86	208,252.71	Other resident sectors
<b>Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)</b>	<b>51,442</b>	<b>59,079</b>	<b>56,924</b>	<b>54,735</b>	<b>54,186</b>	<b>55,022</b>	<b>55,402.28</b>	<b>55,600.64</b>	<b>56,288.36</b>	<b>Liquid deposits (Sight deposits)</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike										Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	166	1,762	2,636	1,335	847	1,268	1,282.05	1,150.70	1,312.16	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	131	78	37	19	0	0	34.12	0.04	0.06	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	3,970	3,554	2,493	3,339	3,562	3,336	3,753.08	3,949.75	3,919.10	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	47,175	53,686	51,758	50,042	49,776	50,419	50,333.03	50,500.15	51,057.04	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>225,021</b>	<b>217,070</b>	<b>203,470</b>	<b>200,041</b>	<b>201,469</b>	<b>201,046</b>	<b>203,252.62</b>	<b>204,351.35</b>	<b>204,674.26</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike	10									Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,465	757	598	1,156	2,355	1,155	1,155.67	3,697.17	4,204.45	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	4,868	5,136	5,114	4,790	4,833	4,342	4,850.24	4,715.20	4,785.96	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,836	7,598	6,379	7,799	10,043	10,675	11,433.20	10,272.23	9,300.44	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	211,841	203,579	191,379	186,272	184,238	184,874	185,813.26	185,666.50	186,383.16	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>594,655</b>	<b>663,836</b>	<b>719,985</b>	<b>720,134</b>	<b>727,436</b>	<b>723,525</b>	<b>712,816.43</b>	<b>708,790.60</b>	<b>711,870.00</b>	<b>In foreign currency</b>
<b>Depozitat e transferueshme</b>	<b>249,078</b>	<b>308,556</b>	<b>354,374</b>	<b>358,779</b>	<b>365,299</b>	<b>361,422</b>	<b>355,008.07</b>	<b>354,705.89</b>	<b>358,041.69</b>	<b>Transferable deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike	82	39	76	105	158	167	199.74	209.11	166.99	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,246	2,465	3,901	4,429	3,738	4,038	3,939.49	5,186.57	6,184.92	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,742	6,143	6,598	6,447	5,139	4,811	4,388.48	4,658.91	4,046.45	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	90,281	116,544	136,911	142,265	145,956	142,006	138,493.11	139,220.06	139,569.37	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	149,726	183,366	206,889	205,533	210,308	210,400	207,987.25	205,431.24	208,073.96	Other resident sectors
<b>Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)</b>	<b>120,699</b>	<b>136,407</b>	<b>139,409</b>	<b>132,046</b>	<b>129,955</b>	<b>129,698</b>	<b>127,840.32</b>	<b>126,099.84</b>	<b>126,081.49</b>	<b>Liquid deposits (Sight deposits)</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike										Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	97	94	101	60	6	6	6.41	6.26	6.29	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	1	10	1	5	0	14	10.77	9.28	9.30	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	5,845	3,739	4,702	5,787	6,210	6,251	6,109.10	7,185.46	6,871.01	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	114,755	132,565	134,605	126,193	123,737	123,426	121,712.49	118,897.33	119,193.37	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>224,878</b>	<b>218,873</b>	<b>226,202</b>	<b>229,309</b>	<b>232,182</b>	<b>232,404</b>	<b>229,968.04</b>	<b>227,984.87</b>	<b>227,746.82</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike		24	984	209	219.3	219.5	217.09	207.31	207.76	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,732	1,519	2,607	2,645	2,931	2,053	2,074.97	1,999.31	2,146.92	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,939	8,936	7,561	7,529	8,041	7,931	7,901.82	7,121.98	6,693.39	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	10,854	12,622	23,903	23,833	21,930	21,679	21,299.26	22,684.71	21,992.66	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	205,353	195,771	191,147	195,093	199,060	200,523	198,474.90	195,971.56	196,706.09	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## Tregues të shëndetit financiar (FSI)

(në përqindje)

## Financial Soundness Indicators (FSI)

(in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Janar'24	Shkurt'24	Mars'24	Prill'24	Maj'24	Prill
<b>Tregues me bazë kapitalin</b>						<b>Capital-based</b>
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)			19.07	-	-	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mIn lekë)			188,296.69	-	-	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mIn lekë)			987,197.88	-	-	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)			17.45	-	-	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve						Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.67	8.64	8.68	8.86	8.65	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.50	9.46	9.49	9.68	9.46	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.08	10.19	10.08	10.22	10.16	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigionet ndaj kapitalit (në %)						Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigionet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	6.31	6.11	6.20	7.23	7.34	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigionet ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.77	5.58	5.67	6.62	6.72	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigionet ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.43	5.18	5.34	6.27	6.25	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	22.52	19.01	19.24	18.81	18.64	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit (në %)						Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.01	6.80	5.58	5.80	5.95	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	4.57	6.21	5.11	5.31	5.44	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	4.31	5.77	4.81	5.03	5.07	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
<b>Tregues me bazë aktivet</b>						<b>Asset-based indicators</b>
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	32.27	32.00	29.90	29.17	28.83	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	31.85	31.75	29.72	29.07	28.65	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	45.25	45.06	42.51	41.86	41.31	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	44.65	44.70	42.24	41.72	41.05	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	2.59	2.20	2.20	2.15	2.18	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	4.88	4.69	4.64	4.82	4.81	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
<b>Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve</b>						<b>Income and expense-based</b>
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	77.50	80.23	79.44	78.87	78.70	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	45.85	48.75	48.92	49.46	50.05	Noninterest expenses to gross income
<b>Të tjera</b>						<b>Other</b>
Numri i bankave	11.00	11.00	11.00	11.00	11.00	Number of banks

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania